

Komisioni Kundër Korrupsionit në raportin e Komisionit Evropian

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) parandalues, i pavarur dhe mëvetshëm. KSHPK-ja plotëson institucionet që ndjekin penalisht korrupsionin, me procedura individuale, zhvillimin e politikave dhe legjislacionin. KSHPK fillimisht është organ parandalues dhe në përputhje me dispozitat ligjore ka kompetenca të kufizuara për zbatimin e masave gjatë shkëlqes së ligjit. Prandaj suksesi në luftën kundër korrupsionit varet nga bashkëpunimi me ekzekutivin dhe gjyqësorin.

Në raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut është vënë në dukje puna proaktive e KSHPK-së. Komisioni vëren progres në luftën kundër korrupsionit përmes rritjes së pjesëmarrjes për hetim, ndjekje penale dhe gjykim të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Ky konkluzion plotësohet me raportin e vitit të kaluar, i cili theksoi se KSHPK-ja në vazhdimësi punon në hapjen dhe zgjidhjen e lëndëve nën juridiksionin e saj, përfshirë edhe rastet e funksionarëve të rangut të lartë. Pozitiv janë vlerësuar edhe propozimet për ndryshime në proceset e punësimit në institucionet publike në drejtim të transparencës më të madhe dhe punësimit të bazuar në merita.

Në raport theksohet se janë siguruar kushte të reja hapësinore për punën e Komisionit, por rekomandohet që shteti të tregojë vullnet politik për të luftuar korrupsionin duke ofruar mbështetje të mëtjshme për organet përkatëse. Krahas mbështetjes me burime financiare dhe njerëzore, të ofrojë udhëzime për institucionet shtetërore për trajtimin e korrupsionit, të cilat do të bazohen dhe në përputhje me rekomandimet e KSHPK-së.

Lufta e suksesshme kundër korrupsionit kërkon përfshirjen e të gjitha institucioneve përkatëse. Shteti duhet të demonstrojë vullnet politik dhe të ofrojë mbështetje dhe qasje nga të gjitha palët e interesuara. KSHPK duhet të bashkëpunojë në mënyrë efektive me aktorë të tjerë si policia, prokuroria publike dhe gjyqësori. Lëndët e KSHPK-së duhet të hiqen nga sirtarët e prokurorisë publike dhe të plotësohen deri në fund. Gjithashtu është jashtëzakonisht e rëndësishme që Qeveria dhe Kuvendi të zbatojnë rekomandimet e Komisionit, të zbatojnë në mënyrë të vazhdueshme Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe të miratojnë Ligjin për të drejtat diskrecionare të personave përgjegjës dhe të ndryshojnë mënyrën e zgjedhjes në shërbimin e lartë drejtues.

Projekti "Biseda anti -korrupsion në Kuvend (Anti-Corruption Talk in Parliament (ACT in Parliament)) përfshin aktivitete kërkimore dhe përfaqësuese me qëllim kryesor, mbështetjen e procesit reformues në Maqedoninë e Veriut, përmes forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit në luftën kundër korrupsionit.

Projekti mbështetet nga Fondi Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për përmbajtjen është përgjegjës IDSCS dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pozicionet e Fondit Nacional për Demokraci (National Endowment for Democracy- NED).

